



Natyrisht që atë nuk e ka ngrohur rezultati i thellë i arritur në fitoren e sotme ndaj Vllaznisë B me rezultatin 7-1. Ernest Gjoka e ka të qartë se kundërshtarët në kampionat do të jenë shumë më të fortë megjithatë ai është i kënaqur nga reagimi i skuadrës së tij. "Natyrisht që niveli i kundërshtarit nuk ishte i lartë por gjithsesi gjej rastin të falenderoj trajnerin Ervis Kraja që na e solli ekipin këtu në Ulqin për të zhvilluar këtë miqësore ndonëse lojtarët e tij nuk ishin në formën optimale. Për ne ishte e rëndësishme të shikonim reagimin e futbollistëve në fushë. Kanë ardhur katër lojtarë të rinj në skuadër dhe ata duhet të ambjentohen me pjesën tjetër të saj. Natyrisht që për Sukajn, Malotën e Mersinin kjo përshtatje mund të jetë më e lehtë ngaqë luajnë prej vitesh në kampionatin shqiptar dhe vetëm Berisha mund ta ketë disi më problem. Por edhe ai besoj se do të ingranohet shumë shpejt. E rëndësishme është që Vllaznia tashmë është më e plotë sepse kemi marrë lojtarë në pozicionet ku kishim më shumë nevojë. Unë jam i kënaqur me merkaton që kemi zhvilluar dhe për këtë gjej rastin të falenderoj presidenten tonë, zonjën Voltana Ademi, për sakrificën e bërë sepse është riformatuar thuajse gjysma e skuadrës. Javën tjetër po shohim mundësinë për zhvillimin edhe të një miqësoreje tjetër me një ekip malazez para se të kthehemi në Shkodër ku do t'i japim dorën e fundit përgatitjeve për ndeshjen e parë të kampionatit".